

Veprimtaria e Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë për periudhën Korrik – Dhjetor 2018

Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë e ushtron veprimtarinë e tij, në mbështetje të Ligjit Nr. 9150, datë 30.10.2003 “Për Urdhrin e Farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Statutit të Urdhrit të Farmacistëve, Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në këtë gjatë mujor pranë Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë është vënë re një fluks i madh i farmacistëve të cilët kanë aplikuar për ndryshimin e vendit të punës, ndryshime këto të cilat kanë konsistuar në: ndryshime të pozicionit të punës të farmacistit të punësuar, të drejtuesit teknik, ndryshim të vendit të punës nga i punësuar në drejtues teknik, anëtarësime të reja si dhe dorëzim të certifikatave, konkretisht:

- 101 raste të ndryshimit të vendit të punës për drejtuesin teknik,
- 48 raste të ndryshimit të pozicionit të punës nga i punësuar në drejtues teknik,
- 133 raste të ndryshimit të vendit të punës për farmacistin e punësuar,
- 30 raste të ndryshimit të pozicionit të punës nga drejtues teknik në të punësuar.

Ndërsa përsa i përket ndryshimeve të vendit të punës për ndihmës farmacistë ka patur vetëm dy raste të ndryshimit të vendit të punës si drejtues teknik në Agjenci Farmaceutike.

Gjatë kësaj periudhe ka patur 73 anëtarësime të reja.

Kemi pasur 52 raste të dorëzimit të certifikatave nga ana e drejtuesve teknik, për arsye të tërheqjes nga vendi i punës apo mbyllje të aktivitetit përkatës. Ka 34 raste të dorëzimit të certifikatave si farmacistë të punësuar dhe 20 raste të dorëzimit të certifikatave të dypunesimit.

Nga ana tjetër përmendim edhe rastet e dypunesimit të farmacistëve të cilat shënojnë 29 raste për këtë periudhe.

Bazuar në Regjistrin Themeltar Kombëtar të anëtarëve të Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë, në formë elektronike dhe manuale, deri në fund të dhjetorit 2018 na rezultojnë gjithsej 2888 farmacistë në gjendje aktive, prej të cilëve 1722 drejtues teknik, 1022 si farmacistë të punësuar dhe 144 të punësuar në institucione shtetërore.

Gjithashtu, përsa iu përket gjykimeve disiplinore, Urdhri i Farmacistëve të Shqipërisë ka qenë pjesë e grupit task force të ngritur me Urdhër Nr. 645, datë 11.09.2018, të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Ogerta Manastirliu.